

Bashkia Librazhd - Kontrata e shërbimit të pastrimit



Shërbimi i pastrimit ofrohet me një kontratë **4 vjeçare me vlerën 32.8 milion lek** nga kompania **“Alko impex Construction”** në 2 zona shërbimi



ZONAT E SHËRBIMIT



Zona 1 – Qyteti i Librazhdit:

- ✓ Grumbullim dhe transportin e mbetjeve të përziera urbane
- ✓ Fshirje manuale/ me fshesë të rrugëve kryesore
- ✓ Lagje të rrugëve kryesore dhe dytësore gjatë 6 muajve të vitit (prill- shtator)



Inceneratori i Elbasanit



34 km

Bashkia Librazhd



2 mjete teknologjike vetshkarkuese i transportojnë mbetjet për trajtim final në Inceneratorin e Elbasanit

Gjatë vitit **2021**, Bashkia Librazhd dërgoi **2,000 ton** mbetje të ngurta urbane në Inceneratorin e Elbasanit



Zona 2 – NJA Qendër, NJA Hotolisht, NJA Orenje, NJA Polis, NJA Lunik

- ✓ Grumbullim dhe transportin e mbetjeve të përziera urbane



Mbetjet e ngurta urbane grumbullohen **të përziera** në **230** kontenierë **1.1m³**, pronë e bashkisë dhe në përdorim nga kompania.



Bashkia Librazhd **monitoron realizimin e shërbimit të pastrimit** nga kompania e kontraktuar çdo ditë me inspektorët e saj



Inspektorët e bashkisë **hartojnë raportet ditore** dhe i dorëzojnë në drejtorinë e shërbimeve publike



Ne, Ju informojmë se:



NË NJA LIBRAZHD

Grumbullimi dhe transporti i mbetjeve të ngurta urbane kryhet **çdo ditë të javës** në orarin 🕒 **23:00 – 06:00**

Pikat me kontenier **1.1m³ dezinfektohen çdo ditë**

Fshirja me fshesë e rrugëve kryesore kryhet çdo ditë të javës në orarin 🕒 **24:00 – 06:00**

Qytetarët ftohen nga Bashkia të hedhin mbetjet e ngurta urbane në kontenierët e përcaktuara nga bashkia në orarin 🕒 **06:00 – 23:00**



NË NJA QENDËR, HOTOLISHT, ORENJE, POLIS, LUNIK

Grumbullimi dhe transporti i mbetjeve të ngurta urbane kryhet **2 ditë të javës** në orarin 🕒 **13:00 – 19:00**

Pikat me kontenier **1.1m³ dezinfektohen çdo ditë kur bëhet largimi i mbetjeve**



Ne, Ju informojmë se:

Këshilli Bashkiak Librazhd ka miratuar paketën fiskale të tarifave dhe taksave vendore për vitin 2020

Çdo familje në **Bashkinë Librazhd** duhet të paguajë  **1,000 lek/vit tarifë pastrimi** në zonën 1 dhe  **500 lek/vit tarifë pastrimi** në zonën 2 së bashku me faturën e ujësjellësit UK- Librazhd

Familjet me status të veçantë janë të përjashtuar nga tarifa e pastrimit

Bashkia Librazhd parashikoi të mbledhë për vitin 2020  **17 million lek/vit**, prej të cilave realizoi  **50%** të tyre, duke mbuluar me **30%** koston e shërbimit të pastrimit.